VENDIM
Nr. 15, datë 1.3.2017

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar	i	Gjykatës	Kushtetuese
Vitore Tusha	anëtare	e	“	“
Vladimir Kristo	anëtar	i	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar	i	“	“
Gani Dizdari	anëtar	i	“	“
Fatos Lulo	anëtar	i	“	“
Besnik Imeraj	anëtar	i	“	“

me sekretare Belma Lleshi, në datën 19.1.2017 mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen nr. 84/20 Akti, që i përket:

KËRKUESE: Pranvera Duhanxhiu

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Nazmije Ferhati, Elida Panganika, Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Tiranë, Drejtoria e Privatizimit të Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme, pranë Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i vendimit nr. 80, datë 10.3.2016 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 142/1, 131/f, 132 dhe 134/1/g të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 6/1 e 13 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Besnik Imeraj, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkueses, që është shprehur për pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, Eleni Panganika, që është shprehur për rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Me vendimin nr. 224/4 prot., datë 17.6.1996, ish-Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (KKKP) Elbasan i ka njohur pronësinë trashëgimtarëve të z. Hysen Abdihoxha për një sipërfaqe trualli prej 80 m², nga të cilat 21,6 m² truall gjenden nën objektin librari, me një sipërfaqe totale prej 57,6 m², duke i dhënë të drejtën e parablerjes për këtë objekt, kur të privatizohet, dhe kompensim me obligacione për sipërfaqen tjetër prej 58,4 m² të zënë nga një pallat me 5 kate dhe trotuar.

2. Kërkuesja, në cilësinë e një prej trashëgimtarëve të z. Hysen Abdihoxha, i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, duke ankimuar vendimin e KKKP-së Elbasan me pretendimin, ndërmjet të tjerash, se sipërfaqja e truallit nën objektin librari është më e madhe se 21,6 m². Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me vendimin nr. 89, datë 21.5.2005, ka vendosur pranimin e kërkesëpadisë, ndryshimin e vendimit nr. 224/4 prot., datë 17.6.1996 të KKKP-së Elbasan, duke u njohur trashëgimtarëve të z. Hysen Abdihoxha të drejtën e parablerjes së librarisë, kur të privatizohet, e cila zë 48 m² të sipërfaqes prej 80 m² të njohur nga ky komision, dhe kompensim me obligacione për pjesën tjetër të sipërfaqes të zënë nga një pallat me 5 kate dhe trotuar. Ky vendim ka marrë formë të prerë në datën 9.2.2005.

3. Në datën 27.2.2007, subjekti i interesuar Nazmije Ferhati, në cilësinë e qiramarrëses (librashitëse) së objektit librari të lartpërmendur, i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan me objekt kundërshtimin e vendimit nr. 224/4 prot., datë 17.6.1996 të ish-KKKP-së Elbasan. Ajo pretendon se ndërtesa librari nuk ndodhet në sipërfaqen ish-pronë e z. Hysen Abdihoxha, pra nuk ka mbivendosje ndërmjet sipërfaqeve përkatëse. Po ashtu, subjekti i interesuar, paditësja në atë gjykim, Nazmije Ferhati, parashtron se libraria është pronë shtetërore në administrim të Drejtorisë së Tregtimit të Librit Artistik dhe Shkencor SHA, dhe se aktualisht ekziston një kontratë qiraje ndërmjet saj dhe kësaj drejtorie, pasi ende nuk

kanë përfunduar procedurat e privatizimit të objektit, të filluara ndërmjet tyre që prej vitit 1996. Në këtë gjykim ka bërë kërkesë për ndërhyrje kryesore Drejtoria e Privatizimit të Ndërmarrjeve të Vogla e të Mesme pranë Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

4. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me vendimin nr. 2266, datë 27.11.2007, ka vendosur pranimin e kërkesëpadisë, ndryshimin e vendimit nr. 224/4 prot., datë 17.6.1996 të KKKP-së Elbasan, duke anuluar këtë vendim në pjesën që u jep trashëgimtarëve të z. Hysen Abdihoxha të drejtën e parablerjes për objektin librari.

5. Gjykata e Apelit Durrës, në bazë të ankimit të kërkueses, me vendimin nr. 10-2009-1031 (503), datë 8.12.2009, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 2266, datë 27.11.2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

6. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2012-820, datë 12.4.2012, ka vendosur në dhomë këshillimi, mospranimin e rekursit të ushtruar nga kërkuesja, pasi nuk përmban shkaqe nga ato që parashikon neni 472 i KPC-së.

7. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, me vendimin nr. 15, datë 19.4.2013, ka vendosur: pranimin pjesërisht të kërkesës, shfuqizimin e vendimit nr. 00-2012-820, datë 12.4.2012 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.

8. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 80, datë 10.3.2016, në seancë gjyqësore, ka lënë në fuqi vendimin nr. 503, datë 8.12.2009 të Gjykatës së Apelit Durrës.

II

9. ***Kërkuesja Pranvera Duhanxhi*** i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) me kërkesë sipas objektit, duke parashtruar këto shkaqe në mënyrë të përmbledhur:

9.1 Gjykata e Lartë ka anashkaluar përfundimet e arsyetuara nga Gjykata Kushtetuese. Sipas Gjykatës Kushtetuese janë konstatuar shkelje të parimit të gjësë së gjykuar dhe sigurisë juridike nga gjykatat e zakonshme.

9.2 Gjykata Kushtetuese është shprehur qartë për parimin *res judicata*, duke cituar se nuk mund të anashkalohet fakti që ndodhemi para të njëjtit objekt padie dhe para të njëjtit shkak ligjor të gjykuar njëherë.

9.3 Pretendimet e Gjykatës Kushtetuese nuk mund të jenë objekt kontrolli nga Gjykata e Lartë. Zbatimi i detyrueshëm i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese është detyrim kushtetues.

9.4 Vendimi i Gjykatës së Lartë nuk përmban kriteret e zakonshme të arsyetimit të vendimit.

10. ***Subjekti i interesuar Eleni Panganika*** ka parashtruar në mënyrë të përmbledhur si më poshtë:

10.1 Referuar nenit 451/a të KPC-së elementet e gjësë së gjykuar kanë të bëjnë me të njëjtat palë në gjykim, të njëjtin objekt dhe të njëjtin shkak të padisë. Në mënyrë që të jemi para gjësë së gjykuar këto elemente duhet të jenë bashkërisht të pranishme, pasi mungesa qoftë edhe e njërit prej tyre do të sillte edhe mungesën e gjësë së gjykuar.

10.2 Nga shqyrtimi i çështjes në gjykatat e faktit ka rezultuar se në vendimin nr. 89, datë 21.5.2005 të Rrethit Gjyqësor Elbasan, me paditëse Pranvera Duhanxhiu, me të paditur KKPP-në dhe me objekt kundërshtimin e vendimit, e ndjera Nazmije Ferhati nuk ka qenë palë e këtij procesi. Ky vendim nuk mund të jetë i detyrueshëm për paditësen dhe për personat e tjerë që nuk kanë qenë pjesë e këtij procesi, ndaj nuk ndodhemi në kushtet e gjësë së gjykuar.

10.3 Gjykata e Lartë duke argumentuar qartë vendimin e saj nuk ka mënjanuar vendimin e formës së prerë të vitit 2005, përkundrazi ka arsyetuar shkaqet përse nuk jemi para gjësë së gjykuar.

10.4 Në rastin konkret vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë është i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai krijon unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre.

10.5 Nga aktekspertimi i ekspertëve ing. topogjeodezistë dhe provat e tjera të administruara në gjykim rezulton se prona për të cilën ka disponuar KKKP-ja me vendimin nr. 224/4, datë 17.6.2006 nuk ndodhet te objekti librari, por 6-7 m në veri të tij. Pra nuk ka mbivendosje, për rrjedhojë kjo pronë nuk zë asnjë m^2 në objektin librari (aktekspertimi, faqe 77–97 e dosjes).

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkueses

11. Gjykata vlerëson se kërkuesja legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131/f dhe 134/1/i të Kushtetutës dhe *ratione temporis*, pasi kërkesa është paraqitur në Gjykatën Kushtetuese brenda afatit të parashikuar nga ligji nr. 8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar.

12. Në lidhje me legjitimimin *ratione materiae*, Gjykata rithekson se kërkuesja i është drejtuar edhe më parë asaj me pretendime për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, duke kundërshtuar disa nga vendimet të cilat janë sërish objekt i kërkesës në shqyrtim. Me vendimin nr. 15, datë 19.4.2013, Gjykata vendosi pranimin pjesërisht të kërkesës, duke shfuqizuar vendimin nr. 00-2012-820, datë 12.4.2012 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në po atë gjykatë për shkak të cenimit të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor. Gjykata vlerësoi se "vendimi i mospranimit të rekursit i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, objekt shqyrtimi, nuk ka respektuar standardin kushtetues të arsyetimit të vendimeve gjyqësore, si për faktin se nuk ka mbajtur qëndrim lidhur me pretendimin e kërkueses për cenimin e parimit të sigurisë juridike (shih paragrafët 10–13 të këtij vendimi), ashtu edhe për shkak të mungesës në përmbajtjen e tij të shkaqeve të parashtruara në rekurs (shih paragrafët 21–23 të këtij vendimi)".

13. Në lidhje me pretendimet e tjera të ngritura në atë kërkesë Gjykata, gjithashtu, ka mbajtur një qëndrim të shprehur në vendimin e sipërcituar.

14. Gjykata ka vlerësuar se pretendimet e kërkueses se gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë shkelur normat procedurale, se është cenuar parimi i paanshmërisë nga ana e gjykatave të zakonshme, se është shkelur parimi i ligjshmërisë në marrjen e provave dhe për ndërgjyqësinë, kanë të bëjnë me zbatimin e ligjit nga ana e këtyre gjykatave. Për rrjedhojë, Gjykata ka çmuar se këto pretendime nuk hyjnë në juridiksionin kushtetues, përderisa kërkuesja nuk ka përcaktuar se cilat standarde kushtetuese janë cenuar.

B. Për pretendimin e cenimit të parimit të sigurisë juridike dhe të arsyetimit të vendimit nga Gjykata e Lartë

15. Kërkuesja pretendon se pas kthimit të çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë vendimi i kësaj të fundit ka anashkaluar përfundimet e arsyetuara nga Gjykata Kushtetuese, e cila ka konstatuar shkelje të parimit të gjësë së gjykuar dhe sigurisë juridike nga gjykatat e zakonshme. Sipas kërkueses zbatimi i detyrueshëm i vendimeve të saj është detyrim kushtetues.

16. Gjykata Kushtetuese rithekson se referuar natyrës së gjykimit kushtetues të kërkesave individuale, kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor është funksion edhe i gjykatave të zakonshme, për më tepër i Gjykatës së Lartë. Ky raport midis juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme, kur është rasti i shqyrtimit nga ana e Gjykatës Kushtetuese të kërkesave individuale, në bazë të nenit 131/f të Kushtetutës, udhëhiqet nga parimi i subsidiaritetit (komplementaritetit) (*shih vendimin nr. 52, datë 2.12.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Gjykata rithekson se zbatimi i detyrueshëm i vendimeve të saj është i garantuar nga Kushtetuta, e cila në nenet 132 dhe 145 të saj sanksionon shprehimisht këtë koncept kushtetues. Vendimet e Gjykatës kanë fuqi detyruese të përgjithshme dhe janë përfundimtare. Ato përbëjnë jurisprudencë kushtetuese dhe, për rrjedhojë, kanë efektet e forcës së ligjit. Ky efekt detyrues ka të bëjë si me pjesën urdhëruese, ashtu edhe me pjesën arsyetuese të vendimit. Në respekt të doktrinës dhe të jurisprudencës kushtetuese, Gjykata ka theksuar se efekti detyrues që pasqyrohet mbi argumentet thelbësore të vendimit të saj përbën edhe një *ratio decidendi*, eliminimi i të cilave do ta bënte vendimin, në tërësinë e tij, të pakuptimtë. Nga kjo pikëpamje Gjykata ka theksuar se nga standardi i detyrimit të zbatimit të vendimmarrjes kushtetuese nuk mund të bëjë përjashtim as vet Gjykata Kushtetuese (*shih vendimin nr. 44, datë 29.6.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Kërkuesja edhe në kërkesën e parë drejtuar Gjykatës Kushtetuese, edhe në kërkesën objekt shqyrtimi pretendon se gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, me vendimet për të cilat kërkohet shfuqizimi, duke anuluar pjesën e vendimit nr. 224/4 prot., datë 17.6.1996 të KKKP-së Elbasan, që u jep trashëgimtarëve të z. Hysen Abdihoxha të drejtën e parablerjes për objektin librari, kur të

privatizohet, nuk kanë mbajtur parasysh vendimin e formës së prerë nr. 89, datë 21.5.2005 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, i cili u ka njohur atyre (trashëgimtarëve) këtë të drejtë (të parablerjes), duke cenuar në këtë mënyrë parimin e gjësë së gjykuar (*res judicata*).

19. Në vendimin e saj të datës 15, datë 19.4.2013 Gjykata Kushtetuese në lidhje me parimin e gjësë së gjykuar është shprehur se "*edhe pse nuk ndodhemi në kushtet e kuptimit klasik të "gjësë së gjykuar", meqenëse vendimi nr. 89, datë 21.5.2005 ka palë ndërgjyqëse të ndryshme nga ato të vendimeve të kundërshtuara, nuk mund të anashkalohet fakti që ndodhemi para të njëjtit objekt padie dhe para të njëjtit shkak ligjor të gjykuar njëherë".* Më tej Gjykata Kushtetuese ka vlerësuar se *"Gjykata e Lartë duhet të mbante një qëndrim të shprehur lidhur me pretendimin e kërkueses për cenimin e parimit të sigurisë juridike*".

20. Pas kthimit të çështjes për rishqyrtim nga Gjykata Kushtetuese, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 80, datë 10.3.2016, ka lënë në fuqi vendimin nr. 503, datë 8.12.2009 të Gjykatës së Apelit Durrës, duke argumentuar: "*Në lidhje me pretendimin palës së paditur se, gjykata ka gjykuar një çështje civile që është gjykuar njëherë për të njëjtin shkak dhe objekt gjykimi dhe kjo është zgjidhur me vendim të formës së prerë, ky Kolegj e konsideron këtë pretendim të pabazuar. Nga shqyrtimi i çështjes në gjykatat e faktit ka rezultuar se, në vendimin nr. 89, datë 21.5.2005 të Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, me paditës Pranvera Duhanxhiu me të paditur K.K.P.Pronave me objekt kundërshtim vendimi rezulton që, e ndjera Nazmije Ferhati të mos ketë qenë palë e këtij procesi. Ky vendim nuk mund të jetë i detyrueshëm për paditësen dhe për personat e tjerë që nuk kanë qenë pjesë e këtij procesi, ndaj nuk ndodhemi në kushtet e gjësë së gjykuar.*

Referuar nenit 451/a të KPC, elementet e gjësë së gjykuar kanë të bëjnë me të njëjtat palë në gjykim, të njëjtin objekt dhe të njëjtin shkak të padisë. Në mënyrë që të jemi para gjësë së gjykuar këta elementë duhet të jenë bashkërisht të pranishëm, pasi mungesa qoftë dhe e njërit prej tyre do të sillte edhe mungesën e gjësë së gjykuar.

Po sipas Gjykatës së Lartë "*nga shqyrtimi i çështjes në gjykatat e faktit ka rezultuar se, në vendimin nr. 89, datë 21.5.2005 të Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, me paditës Pranvera Duhanxhiu me të paditur KKPP me objekt kundërshtim vendimi rezulton që, e ndjera Nazmije Ferhati të mos ketë qenë palë e këtij procesi. Ky vendim nuk mund të jetë i detyrueshëm për paditësen dhe për personat e tjerë që nuk kanë qenë pjesë e këtij procesi, ndaj nuk ndodhemi në kushtet e gjësë së gjykuar. Në interpretim dhe zbatim të ligjit, vendimi gjyqësor i formës së prerë që e ka zgjidhur çështjen në themel, përbën një zgjidhje të natyrës përfundimtare dhe të qëndrueshme të mosmarrëveshjes si në kuptimin konstituiv, ashtu dhe atë prekluziv. Në kuptimin konstituiv ai jep zgjidhjen përfundimtare të mosmarrëveshjes, pozitave të palëve të kundërta në atë gjykim, ndërsa në kuptimin prekluziv ndalohet mundësia e kërkimit në gjykatë të ndryshimeve në zgjidhjen e mosmarrëveshjes së përcaktuar me vendimin gjyqësor të formës së prerë. Pra autoriteti dhe efektet e gjësë së gjykuar janë përfundimi i procesit civil dhe pamundësia e të njëjtave palë ndërgjyqëse për t'i kërkuar gjykatës që të shqyrtojë dhe vendosë përsëri mbi të njëjtin objekt gjykimi (res iudicata est)*.".

21. Duke vlerësuar zbatimin e standardeve të mësipërme gjatë shqyrtimit të çështjes konkrete, Gjykata konstaton se Gjykata e Lartë i ka përmbushur detyrimet që rrjedhin nga vendimi nr. 15, datë 19.4.2013 për të zhvilluar një proces të rregullt ligjor gjatë rishqyrtimit të çështjes në po atë gjykatë. Në zbatim të vendimit detyrues të Gjykatës, Gjykata e Lartë, në përputhje me kompetencat e saj ligjore, pasi ka marrë në shqyrtim pretendimet e ngritura në rekurs, duke kaluar çështjen për shqyrtim në seancë gjyqësore, ka vlerësuar se vendimi nr. 503, datë 8.12.2009 i Gjykatës së Apelit Durrës është i drejtë dhe për këtë arsye e ka lënë në fuqi atë.

22. Gjykata ripohon se e drejta për një proces të rregullt ligjor, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142/1 të Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së, përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar.

23. Në rastin konkret, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkueses kanë të bëjnë me çështje të natyrës ligjore dhe si të tilla i takojnë për zgjidhje gjykatave të zakonshme. Veçanërisht vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, ku ngrihen pretendimet për cenim të parimit të arsyetimit të vendimit, në pjesën e tij hyrëse përmban palët ndërgjyqëse, objektin e padisë, disponimet e gjykatave më të ulëta dhe shkaqet e rekursit të paraqitur nga pala e paditur në proces. Vendimi përmban edhe vlerësimin e Gjykatës së Lartë në lidhje me shkaqet e rekursit, si dhe argumentet që e kanë çuar atë në qëndrimin e shprehur në dispozitiv. Në këtë kuptim, Gjykata çmon se vendimi i kundërshtuar nuk rezulton të jetë jologjik, të ketë kundërthënie, të mos ketë referencë në ligjin e zbatueshëm dhe të mos respektojë elementet e përmendura më sipër, duke përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e vendimit objekt shqyrtimi. Gjykata e

Lartë, për shkak të pozicionit dhe rolit të saj si gjykatë ligji, shqyrton rekurset për pretendime të shkeljes së ligjit material ose procedural, gjë që përbën funksionin kryesor të saj. Ajo analizon çështjen në drejtim të kontrollit të ligjshmërisë dhe bazueshmërisë së vendimeve të ankimuara. Në zbatim të parimit të subsidiaritetit, kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor është funksion edhe i gjykatave të zakonshme, për më tepër i Gjykatës së Lartë. Raporti ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme, kur është rasti i shqyrtimit nga ana e kësaj Gjykate i kërkesave individuale, në bazë të nenit 131/f të Kushtetutës, udhëhiqet nga parimi i subsidiaritetit (komplementaritetit). Një qëndrim i ndryshëm do ta kthente Gjykatën Kushtetuese në një instancë të zakonshme, gjë që nuk është funksioni i saj (*shih vendime nr. 42, datë 7.7.2014; nr. 62, datë 23.9.2015; nr. 37, datë 30.6.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Bazuar në sa më sipër, Gjykata arrin në përfundimin se pretendimi i kërkueses për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor është i pabazuar.

25. Po ashtu, në vlerësimin e Gjykatës arsyetimi i vendimit nr. 00-2016-726(80), datë 10.3.2016 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nuk paraqet ndonjë mangësi, e cila mund të ndikojë në cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor. Ky vendimi është i qartë në interpretimin dhe zbatimin e ligjit, si dhe lidhur me faktet që janë konsideruar të provuara.

26. Gjykata çmon se dhe pretendimi për cenimin e parimit të sigurisë juridike në rastin konkret lidhet me mënyrën e interpretimit dhe zbatimit të ligjit nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, dhe si i tillë nuk hyn në juridiksionin kushtetues.

27. Në përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkueses për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, janë të pabazuara.[1]

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/f dhe 134/1/i të Kushtetutës, si dhe të neneve 72, 77 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar), Vitore Tusha, Gani Dizdari, Besnik Imeraj, Fatos Lulo
Anëtarë kundër: Fatmir Hoxha
Anëtarë pjesërisht kundër: Vladimir Kristo

MENDIM PAKICE

1. Shumica ka vendosur rrëzimin e kërkesës së shtetases Pranvera Duhanxhiu. Nuk pajtohem me vendimin e shumicës për arsyet si më poshtë.

2. Nga rrethanat e çështjes, sikurse konstaton edhe shumica, rezulton se çështja është shqyrtuar edhe një herë nga kjo Gjykatë (*vendimi nr. 15, datë 19.4.2013 i Gjykatës Kushtetuese*) dhe pas kthimit të çështjes për rigjykim në Gjykatën e Lartë, kjo e fundit, me vendimin nr. 80, datë 10.3.2016, në seancë gjyqësore, ka lënë në fuqi vendimin nr. 503, datë 8.12.2009 të Gjykatës së Apelit Durrës. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë në lidhje me pretendimin e kërkueses se çështja është gjykuar njëherë për të njëjtin shkak dhe objekt gjykimi dhe është zgjidhur me vendim të formës së prerë, ka argumentuar se "*nga shqyrtimi i çështjes në gjykatat e faktit ka rezultuar se në vendimin nr. 89, datë 21.5.2005 të Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, me paditës Pranvera Duhanxhiu me të paditur K.K.P.Pronave me objekt kundërshtim vendimi rezulton që, e ndjera Nazmije Ferhati të mos ketë qenë palë e këtij procesi. Ky vendim nuk mund të jetë i detyrueshëm për paditësen dhe për personat e tjerë që nuk kanë qenë pjesë e këtij procesi, ndaj nuk ndodhemi në kushtet e gjësë së*

[1] Gjyqtari F. Hoxha u shpreh për pranimin e kërkesës, sipas qëndrimit të mbajtur në Mendimin Paralel të vendimit nr. 15, datë 19.4.2013 të Gjykatës Kushtetuese.

gjykuar. Referuar nenit 451/a të KPC, elementet e gjësë së gjykuar kanë të bëjnë me të njëjtat palë në gjykim, të njëjtin objekt dhe të njëjtin shkak të padisë. Në mënyrë që të jemi para gjësë së gjykuar këta elementë duhet të jenë bashkërisht të pranishëm, pasi mungesa qoftë dhe e njërit prej tyre do të sillte edhe mungesën e gjësë së gjykuar" (shih paragrafin nr. 20 të vendimit të shumicës).

3. Në këto kushte, kërkuesja i është drejtuar përsëri kësaj Gjykate duke pretenduar cenimin e parimit të sigurisë juridike dhe të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor.

4. Shumica i ka analizuar pretendimet e kërkueses në këndvështrim të respektimit të parimeve të lartpërmendura dhe ka konstatuar se Gjykata e Lartë i ka përmbushur detyrimet që rrjedhin nga vendimi nr. 15, datë 19.4.2013 i kësaj Gjykate për të zhvilluar një proces të rregullt ligjor gjatë rishqyrtimit të çështjes. Sipas shumicës, në zbatim të vendimit detyrues të Gjykatës, Gjykata e Lartë, në përputhje me kompetencat e saj ligjore, pasi ka marrë në shqyrtim pretendimet e ngritura në rekurs, duke kaluar çështjen për shqyrtim në seancë gjyqësore, ka vlerësuar se vendimi nr. 503, datë 8.12.2009 i Gjykatës së Apelit Durrës është i drejtë dhe për këtë arsye e ka lënë në fuqi atë (*shih paragrafin nr. 21 të vendimit*). Konkretisht, shumica ka çmuar se pretendimi për cenimin e parimit të sigurisë juridike në rastin konkret lidhet me mënyrën e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, dhe si i tillë nuk hyn në juridiksionin kushtetues (*shih paragrafin nr. 26 të vendimit*) dhe se vendimi i kundërshtuar nuk rezulton të jetë jologjik, të ketë kundërthënie, të mos ketë referencë në ligjin e zbatueshëm dhe të mos respektojë elementet e përmendura më sipër, duke përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e vendimit objekt shqyrtimi (*shih paragrafin nr. 23 të vendimit*).

5. Në ndryshim nga shumica jam i mendimit se Gjykata e Lartë vetëm formalisht ka respektuar vendimin e Gjykatës Kushtetuese dhe detyrimet që rrjedhin prej këtij vendimi. Sikurse jam shprehur në mendimin paralel të vendimit nr. 15, datë 19.4.2013 të kësaj Gjykate, në thelb, vendimet e gjykatave të zakonshme objekt shqyrtimi disponojnë mbi një gjë të gjykuar, që është e drejta e parablerjes, e cila i është njohur kërkueses me vendimin gjyqësor të formës së prerë nr. 89, datë 21.5.2005 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan. Ky qëndrim është pohuar edhe nga shumica në vendimin nr. 15, datë 19.4.2013 të kësaj Gjykate kur arsyeton se *vendimi nr. 89, datë 21.5.2005 ka palë ndërgjyqëse të ndryshme nga ato të vendimeve të kundërshtuara dhe nuk mund të anashkalohet fakti që ndodhemi para të njëjtit objekt padie dhe para të njëjtit shkak ligjor të gjykuar njëherë (shih paragrafin nr. 19 të vendimit*). Pra, me fjalë të tjera, vendimet gjyqësore objekt kundërshtimi dhe vendimi i formës së prerë në thelb kanë objekt dhe shkak ligjor të njëjtë.

6. Sipas jurisprudencës kushtetuese parimi i gjësë së gjykuar përfshin jo vetëm urdhërimet e dispozitivit të vendimit gjyqësor, por edhe zbatimin e së drejtës së përcaktuar në pjesën përshkruese arsyetuese të vendimit, me kusht që ato të jenë kryer me qëllim dhënien e vendimit gjyqësor dhe t'u përkasin fakteve ose marrëdhënieve që kanë formuar objektin e gjykimit mbi të cilin gjykata ka dhënë vendimin e saj (*shih vendimin nr. 36, datë 25.7.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

7. Në këtë drejtim Gjykata ka theksuar se dhënia e vendimeve të ndryshme gjyqësore për çështje të njëjta bie ndesh me parimin e sigurisë juridike në praktikën gjyqësore. Parimi i sigurisë juridike nënkupton, ndërmjet të tjerash, garantimin e besueshmërisë së individit te shteti, institucionet e tij dhe tek aktet që ato nxjerrin. Ndërsa në rastin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë siguria juridike nënkupton se nëse gjykata ka vendosur përfundimisht për një çështje, vendimi i saj nuk duhet të vihet në dyshim. Pra, kur vendimi ka marrë formë të prerë ai është i detyrueshëm për palët, trashëgimtarët e tyre, për personat që tërheqin të drejta nga palët, për gjykatën që ka dhënë vendimin dhe për të gjitha gjykatat dhe institucionet e tjera. Vendimi gjyqësor i formës së prerë, që përbën gjë të gjykuar, është shprehje dhe konkretizim i së drejtës mbi marrëdhënien juridike dhe ka qëllim t'i japë jo vetëm qartësi, por edhe siguri kësaj marrëdhënieje (*shih vendimin nr. 21, datë 16.4.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

8. Të njëjtin qëndrim ka mbajtur edhe Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut, e cila ka nënvizuar se *"...në pikëpamjen e Gjykatës, parimi në bazë të të cilit një vendim përfundimtar i formës së prerë është gjë e gjykuar dhe zgjidh mosmarrëveshjen midis palëve me një efekt përfundimtar është një element themelor i së drejtës për një gjykim të drejtë, që garantohet nga neni 6 i Konventës në çështjet civile. Parimi i sigurisë juridike dikton që kur një mosmarrëveshje civile është shqyrtuar në themel nga gjykata, vendimi i saj nuk vihet më në diskutim" (shih çështjen Kehaya dhe të tjerë kundër Bullgarisë, datë 12.1.2006).* Kjo Gjykatë në disa çështje kundër Shqipërisë ka evidentuar rëndësinë e sigurisë juridike në procesin e kthimit dhe të kompensimit të pronave, veçanërisht për sa u përket të drejtave të fituara nga vendimet që kanë njohur të drejta pronësie dhe të

ruajtjes së garancive që lidhen me këto të drejta *(shih Ramadhi dhe të tjerë kundër Shqipërisë, datë 13.11.2007; Hamzaraj kundër Shqipërisë, datë 3.2.2009; Manushaqe Puto dhe të tjerë kundër Shqipërisë, datë 31.7.2012*).

9. Në çështjen konkrete konstatoj se shumica duke arsyetuar se mënyra e interpretimit dhe zbatimit të ligjit nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm nuk hyn në juridiksionin kushtetues (gjë që në parim në kontekstin e duhur është e drejtë), ka rënë në "kurthin" e këtyre gjykatave. Ajo e ka mbështetur vendimin e saj, njësoj si Gjykata e Lartë, në një dispozitë ligjore të Kodit të Procedurës Civile (neni 451/a), ndërkohë që "gjëja e gjykuar", si pjesë përbërëse e rëndësishme e parimit të sigurisë juridike dhe shtetit të së drejtës, duhet të përbënte pikënisjen e arsyetimit dhe vendimmarrjes së saj lidhur me problemin themelor të shtruar për zgjidhje në këtë çështje, faktin se në të gjitha nivelet e gjykimit kërkueses i është njohur e drejta e parablerjes e pronës objekt konflikti me vendim të formës së prerë.

10. Në vijim të arsyetimit dhe standardeve të mësipërme, duke qenë se Gjykata e Lartë në rishqyrtimin e çështjes ka anashkaluar jo vetëm jurisprudencën e GJEDNJ-së për çështje të ngjashme, por edhe orientimet e dhëna në vendimin e mëparshëm të kësaj Gjykate, vlerësoj se në përmbushje të standardit kushtetues mbi forcën detyruese të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, ishte detyrë e kësaj të fundit t'i jepte përgjigje pretendimit nëse kërkueses i është cenuar ose jo nga vendimmarrja e gjykatave të zakonshme parimi i sigurisë juridike.

11. Në të kundërt, një vendim formal si ai i shumicës e kthen këtë Gjykatë në një shkallë të katërt të gjyqësorit, pasi nuk u jep përgjigje përfundimtare pretendimeve me natyrë kushtetuese që hyjnë në kompetencën e saj.

Anëtar: Vladimir Kristo